



*Parents Are Our Partners*  
THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

ZYRA E ANGAZHIMIT TË PRINDIT, FAMILJES, KOMUNITETIT  
DHE PARTNERITETEVE TE BESIMIT  
440 N. BROAD STREET, DHOMA 114  
FILADELFA, PA 19130  
215-400-4180 (TEL)  
215-400-4181 (FAKS)  
WWW.PHILASD.ORG/PARENTUNIVERSITY

## **Procedurat e Pranimit në Universitetin e Prindit**

Të dashur Prindër,

Ju falenderojmë për interesin e çfaqur ndaj programit 'Universiteti i Prindit' të Filadelfias. Ne jemi të gëzuar për programin që ju ofrojmë, duke qënë të sigurtë se eksperiencia e fituar do të jetë e dobishme për të gjithë pjesëmarrësit.

Prindërit e interesuar duhet të plotësojnë dhe dërgojnë me postë aplikimin zyrtar. Universiteti i Prindit do të marrë vendim për pranim, menjëherë me marrjen e aplikimit. Prindërit do të marrin përgjigjen e pranimit përmes shërbimit postar të SHBA. Ju gjithashtu, mund të kontrolloni statusin për aplikimin tuaj duke telefonuar në 215-400-4180, ose me e-mail në [callcenter@philasd.org](mailto:callcenter@philasd.org).

- Letra e pranimit do të japë datat e fillimit dhe mbarimit të klasave. N.q.s ju vendosni të mos merrni pjesë, ju lutemi telefononi në numrin 215-400-4180 dhe ne do ju çrregjistrojmë emrin nga lista e klasës.
- N.q.s klasa është e plotësuar, ne do ju dërgojmë njoftim për t'ju bërë të ditur që emri juaj është në listën e pritjes për këtë klasë. Ne do ju njoftojmë menjëherë sapo të krijohet vend i lirë, ose porsa klasa e ardhëshme të jetë formuar.

E mirëpresim pjesëmarrjen tuaj në Universitetin e Prindit të Filadelfias.

Sinqerisht,

*The Staff of Parent University of Philadelphia*

## **VLERESIMI MBI UNIVERSITETIN E PRINDIT**

"Universiteti i prindit është programi më i mirë!  
Klasat u japin prindërve ide të reja në punën me fëmijët dhe i ndihmojnë ata në përmirësimin e ambientit të mësimin. Këto klasa janë shumë të vlefshme, edukative dhe të dobishme për fëmijët."  
*Maya McKinney*

"Klasat janë një burim shumë i mirë komunikimi në punën tonë për dhënien e rrugës së drejtë fëmijëve."  
*Carole Williams*

"Klasat më kanë ndihmuar shumë në gjetjen e rrugës më të mirë, për trajtimin e problemeve në familjen time. Ato janë një burim i madh!" *Cassandra Brown*

"Ju faleminderit për këtë vizion të mrekullueshëm për prindërit e fëmijëve në shkollat publike të Filadelfias." *Ernestine Bristow*

"Universiteti i prindit është shumë i rëndësishëm për ne, si prind dhe fëmijët tanë. Klasat janë një mjet i shkëlqyer që më ndihmojnë në aftësitë e mia prindërore. Kam mësuar ide te reja, se si të bashkëpunojë me fëmijët e mi."  
*Jose Ramirez*

"Dua të falenderojë Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, që më dhanë mundësinë të marrë pjesë në program." *Autumne Hall*